

Akademia Shqiptaro-Amerikane

2007-2008

- ❖ Grupi i pare parashkollor : Femije dhe Prinder, e përshtatshme për fëmijët e moshës 3, 4 dhe 5 vjeç.
- ❖ Grupi i dyte parashkollor: e përshtatshme për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeç.
- ❖ Niveli 1 (Fillestar): e përshtatshme për fëmijët e moshës 7 deri ne 10 vjeç.
- ❖ Niveli 2 (Mesatar) e përshtatshme për fëmijët e moshës 10 deri ne 13 vjeç.
- ❖ Anglisht per te rriturit

❖ **Grupi pare parashkollor -Femije dhe Prinder (3, 4 dhe 5 vjeç)**

Qellimi i ketij grupi eshte familiarizimi i femijve me gjuhen shqipe. Femijet ekspozohen me shqipen nepermjet lojrave dhe komunikimit me femije e prinder te tjere. Njekohesisht, prinderve u jepet mundesia te njihen me prinder te tjere te interesuar ne ekspozimin e femijeve ndaj shqipes qe ne moshe te vogel.

Ne kete kurs, nen drejtimin e mesueses, femijet mesojne te numerojne, te njohin ngjyrat, kafshet, pjeset e trupit, kohen, stinet, automjetet dhe te tjera aspekte te komunikimeve fillestare. Ne rutinen javore, perfshihen mesime kengesh, lojrash, festimet e festave tradicionale shqiptare si dhe udhetime ne natyre. Mesimi zhvillohet ne forme loje. Femijet marrin pjese dhe pershendesin ne aktivitet e ndryshme qe organizohen nga komuniteti shqiptar. Ne varesi te nevojave specifike te femijeve, rekomandohet qe komunikimi me femijet gjate mesimit te behet kryesisht ne gjuhen shqipe.

❖ **Grupi i dyte parashkollor (5 dhe 6 vjeç)**

Ne kete kurs, temat e permendura me lart zhvillohen me gjere dhe me pasur. Femijet mesojne te prezantohen a pershendesin, njohin ushqimet, ditelindjet, mjedisin, veshjen, komunikimin ne treg etj. Femijet fillojne gjithashtu te mesojne elementet e para te alfabetit. Pervetesimi i fjalorit behet nepermjet lojrave, kengeve, kercimit, vizatimeve e montazheve si dhe udhetimeve ne natyre. Gjithashtu, nepermjet lojrave e shembujve konkrete, femijet ekspozohen me zgjedhimin e foljeve te thjeshta dhe shumesin e rregullt e te crregullt. Femijet mesojne te kendojne e te recitojne kenge tradicionale per femije si dhe poezi te thjeshta me te cilat mund te pershendesin festat qe organizohen nga komuniteti shqiptar.

❖ **Niveli 1 (Fillestar 7-10 vjeç)**

Ky kurs ka për fokus konstruktin e fjalise, pasurimin e fjalorit si dhe përvetësimin e rregullave baze gramatikore. Nepermjet degjimit, leximit, bisedave dhe të shkruarit shqip, fëmijet përdorin aspekte të ndryshme të komunikimit për të thelluar njohjen me gjuhën shqipe. Fëmijet njohin dhe përvetësojnë abetaren. Gjithashtu, duke lexuar dhe diskutuar pjesë letrare fillestare, fëmijet pasurojnë fjalorin dhe ekspozohen me koncepte të ndryshme gramatikore të gjuhës shqipe si lakimi i emrave, zgjedhimi dhe kohet e foljeve, përdorimi i parafjalëve, e mbiemrave. Gjate këtij kursi, lojra të ndryshme edukative do të përdoren si mjet ndihmes që fëmijet të njihen me traditat, gjeografine dhe historinë e Shqipërisë. Në fund të këtij kursi fëmijet janë të aftë të marrin pjesë në biseda të thjeshta në gjuhën shqipe.

❖ **Niveli 2 (Mesatar, 10-13 vjeç)**

Qëllimi i këtij kursi është përmirësimi i mëtejshëm i të folurit dhe të shkruarit në shqip, duke e vënë theksin në përdorimin e gjuhës së pastër nga ana gramatikore. Fëmijet inkurajohen të shkruajnë e të lexojnë në shqip; përvetësimi i njohurive gjuhësore dhe gramatike përforcohet nepermjet leximit dhe bashkëbisedimeve të pjesëve letrare klasike, përrallave, gojedhanave shqiptare. Po nepermjet leximeve të teksteve letrare, fëmijet njihen gjithashtu dhe me historinë e Shqipërisë nga lashtësia deri në ditët e sotme. Fëmijet punojnë në grupe për të krijuar apo vënë në skenë fragmente nga leximet letrare e historike. Në fund të këtij kursi fëmijet janë të aftë të bisedojnë dhe të shkruajnë në shqip me fjali të thjeshta por të sakta nga ana gramatikore. Gjithashtu, fëmijet kanë fituar njohuri me të plotë për kulturën e historinë e kombit shqiptar.

❖ **Anglisht per te rriturit**

Qellimi i ketij kursi eshte qe te ndihmoje bashkatdheteret shqiptare me banim ne zonen metropolitane te Uashingtonit per te zoteruar sa me mire gjuhen angleze. Per te ndihmuar ne pervetesimin e sakte si te gjuhes se folur amerikane ashtu edhe te komunikimeve baze, ne zhvillimin e kurseve, pervec mesuesve me pervojete te gjate arsimore, do te marrin pjese edhe te rinj me origjine shqiptare te cilet perdorin anglishten si gjuhe te pare.